


NENDORI

REVISTË E PËRMUAJSHME
LETRARE — ARTISTIKE
SHOQËRORE — POLITIKE

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË



Fabrika e qelqit — Korçë

8

Viti XIV i botimit

Gusht — 1967

L E N D A

Ismail Kadare — Dasma, roman (variant i shkurtuar)	3
Hilmi Tukaj — Rruga e re, fragment poeme	105
Lumira Berati — Këngë fitimtare, vjershë	106
Luljeta Muço — Dëgjo, o Cem — Varje për duart, vjersha	107
Naxhije Gripshi — Bri rrugës së vjetër, një rrugë e re — Punojmë dhe vigjëlojmë, vjersha	108
Sami Rubi — Kështu e filluam ne..., vjershë	110
Tom Ded Mokaj — Lum e lum për ty Parti, vjershë	110
Spiro Xhai — «... Dhe pranvera erdh», reportazh	113
Isuf Nelaj — Delegatja, vjershë	124
Fatmir Smajli — Zemra fshatare, vjershë	126
Agim Faja — Kooperativistja — Mësuesja e fshatit me kooperativistet në ara. — Shoqet kooperativiste — Në pushim — Në kërkim të thesarit, skica	127
Resul Bedo — Te varri i Mangës	137
Ndreko Rino — Edhe i liruar, kufitar.	140
Safo Marko — Punojmë dhe mbrojmë, pllakat	147
Adelina Mamaqi — Shkollë për të rejttona, reportazh	149
Stefan Kume — Për tokën mëmë, vjershë	160
KRITIKË LETRARE ARTISTIKE	
Lazar Siliqi — Tue përkujtue Ndre Mjedën (me rastin e 30-vjetorit të vdekjes)	162
Mark Gurakuqi — Tema antifetare në veprën e Migjenit.	175

ISMAIL KADARE

Mbyllën me sukses sezonin teatral 1966-67 — Opera «Hroina» e Vangjo Novës — Seminar për muzeumet — Festivali 3-të i këngës për fëmijë..... 189

LIBRA TË REJA

«Rrugë të tërthorta» — «Legjenda e një fisi» — «Bij revolucionarë të partisë» — «Këngët e para» — «Pushkë në bregdet» — «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes»..... 198

ME DY FJALE

Në kopertinë: «Ndërtuesja» — skicë nga Agim Faja.

207



roman *)

E shikon atë lëkurë dhije të mbërthyer në listel? Bjeri me shkop dhe mbi të do të gjëmojnë të gjitha zhurmat e jetës, që nga përkundja e djepit gjér te rropamat e luftrave.

(Nga bisedat në një dasmë)

Një të diel marsi, në sektorin N. të linjës hekurudhore, u gjet një mëngjes herët një shinë e dëmtuar. Ajo u bë shkak, që treni i pasagjerëve, i cili po bënte udhëtimin e zakonshëm, të vonohej gjashtë minuta. Nga shqyrtimi i menjëherëshëm i çështjes, që bëri Drejtoria e hekurudhave, nuk doli në fillim asgjë e qartë. Dikush kish telefونuar në mëngjes në drejtori dhe kish lajmëruar se linja ishte ndërprerë. Ai kish thënë se këtë gjë e kishin bërë me siguri ca dasmorë të dehur, të cilët ai po i shikonte tani me sytë e tij, se si po mundoheshin të ndreqnin gabimin, duke montuar me shpejtësi shinën, që kishin hequr nga vëndi gjatë natës. Një maqinist, që kish kaluar me trenin e tij pas mesnatës në atë sektor dhe që u ndodh në atë kohë në drejtori, pohoi se vërtet aty afër bëhej një dasmë e madhe. Ai e kish dëgjuar daullen dhe zhurmat e dasmës të dy herët, që kaloi atë natë me trenin e tij të mallrave. Inspektorët erdhën në përfundimin e shpejtë se, me sa duket, pas mesnatës, disave prej dasmorëve të dehur (u muarr vesh se shumica e tyre ishin montatorë), në pije e sipër, u shkrepit në kokë të çmontonin shinat pranë stacionit.

E vërteta qëndronte krejt ndryshe.

*) Variant i shkurtuar.